

PROTOKOLLI I VERDHE I MASAVE HIGJENO-SANITARE COVID-19

Subjekti fillimisht verifikon objektin e veprimtarisë së tij duke vetëpërcaktuar nivelin e riskut sipas kodeve të veprimtarisë. Në rast të aktiviteteve me natyrë të përzier ku një subjekt ushtron disa aktivitete, vetëpërcaktimi do të kryhet sipas adresave sekondare dhe llojit të çdo aktiviteti. Subjekti lejohet të veprojë vetëm në orarin e caktuar.

Këtij protokollit i nënshtrohen edhe aktivitetet që kanë 25-50 punonjës që punojnë në një ambient të përbashkët të mbyllur.

Personi i caktuar nga administratori/Personi Fizik:

- Kryen çdo ditë vlerësimin për prezencën e simptomave të COVID-19 në personat e punësuar. Në rast të simptomave nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe duhet të raportohet menjëherë si rast duke telefonuar në numrin 127. Nëse personi shfaq simptoma ndërkohë që është duke punuar apo pas punës, ky person duhet të karantinohet në një ambient të veçuar të objektit derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore;
- Për çdo rast Administratori/Personi Fizik Tregtar lajmëron menjëherë strukturat përkatëse veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Inspektoriatin e Shëndetit Publik.

Personi i caktuar nga administratori/personi fizik mat temperaturën e punonjësve dhe të çdo personi tjetër klient në hyrje dhe dalje me termometër *infrared* dhe njofton menjëherë strukturat përkatëse për temperaturat me të larta se 37,5 gradë në rastet kur ka edhe simptoma të tjera të COVID-19.

Subjekti duhet të:

- Sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment doreza mbrojtëse, maska dhe higjenizues duarsh me mbi 60% alkol;
- Sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment sapun, letër për pastrimin e duarve, dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve si dhe kosha plehrash të mbyllur të cilët duhen pastruar çdo ditë;
- Ofrojë produktin higjenizues të duarve për personelin dhe këdo që hyn e del në ambientet e brendshme dhe të kujdeset për rimbushjen e tyre. Përqindja e substancës aktive duhet të jetë minimalisht 60% alkol;
- Garantojë dhe respektojë në çdo moment distancën prej 2 metra midis personelit të punësuar dhe këtyre të fundit e klientëve. Subjekti riorganizon punën e tij me turne sipas një plani individual në mënyrë që të respektojë detyrimin e mësipërm;

- Kryejë dezinfektim të ambientit dhe larje para hapjes dhe pas mbylljes dhe të paktën 3 herë në ditë. Sipërfaqet e papastra lahen fillimisht me ujë dhe sapun e më pas dezinfektohen me produktet e tjera. Secili punonjës kryen dezinfektimin me produktet e higjenës të tavolinave, banaqeve, telefonave, kompjuterave, kufjeve dhe çdo hapësirë apo objekti ku ka patur kontakt prekje në fillim dhe përfundim të turnit. Produktet përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse nga prodhuesi/shitësi apo Minsitria e Shëndetësisë;
- Vendosë xham mbrojtës (*plexiglass*) midis punonjësit dhe klientit;
- Shërbejë aq klientë sa sportele arke apo shërbim klienti ka, ndërkohë që të tjerët presin jashtë në rradhë;
- Afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas *checklist* të miratuar;
- Afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas formatit të miratuar;
- Afishojë deklaratën për zbatimin e protokollit të verdhë, sipas formatit të miratuar ku përfshihet detyrimi për vetëvlerësim të simptomave nga personeli i punësuar/administratori/çdo person tjetër palë e tretë që hyn e del në ambientet e brendshme sipas formatit të miratuar ku përmendet përgjegjësia administrative apo penale për personin që nuk merr masat sipas detyrimeve ligjore si dhe numri jeshil për denoncim;
- Afishojë të plotë protokollin e verdhë sipas tekstit të miratuar.

Materialet e mësipërme afishohen në hyrje të subjektit si dhe në vende të dukshme në brendësi të subjektit.

Punonjësit:

- Kryejnë çdo ditë vetë-vlerësimin personal nëse kanë simptoma të COVID-19 sipas *checklist* të miratuar. Në rast të simptomave personi duhet të njoftojë menjëherë me telefon numrin 127 dhe Administratorin/Personin Fizik Tregtar. Nuk duhet lejuar në asnjë rast vijimi i aktivitetit nga personi përkatës dhe sipas rastit duhet të karantinohet në ambientin e paracaktuar;
- Janë të detyruar të deklarojnë ndaj Administratorit/Personit Fizik Tregtar nëse kanë patur kontakt me persona të cilët rezultojnë apo kanë rezultuar pozitiv me COVID-19;
- Nëse vërejnë shenja klinike gjatë qëndrimit në banesë nuk duhet të paraqiten në punë dhe duhet të lajmërojnë menjëherë Administratorin/Personin Fizik Tregtar dhe të telefonojnë numrin 127 dhe mjekun e familjes;
- Gjatë punës nuk duhet të përdorin mjetet apo vendin e punës së kolegëve pa kryer dezinfektimin.

Rregulla të përgjithshme:

- Vajtja dhe ardhja në punë në këmbë kryhet duke ruajtur distancën 2 metra dhe jo duke krijuar grupime. Në rast të vajtje ardhjes në punë me shërbim transporti me autobuzë, punonjësit ulen në anësoret e dritareve të autobuzit dhe duke lënë një hapësirë rreshti bosh pas tyre. Në autobus apo automjet duhet mbajtur detyrimisht maska dhe dorezat dhe të shamngjet prekja e sipërfaqeve. Autobusi dezinfektohet dhe ajroset çdo ditë. Për lëvizjen me automjet të zbatohen masat e publikuara nga Policia e Shtetit;
- Gjatë pushimit apo orarit të ngrënies të shmanget grumbullimi i personave në ambiente si kuzhina, dhoma ngrënie apo ambiente të jashtme qoftë të subjetit apo publike;
- Kollitja dhe tështitja kryhen duke përdorur bryllin apo letër hundësh. Letra hidhet menjëherë në kosh;
- Në asnjë rast nuk lejohet kontakti fizik mes punonjësve apo mes palëve të treta, përfshirë përshëndetjet;
- Personeli i punësuar dhe personat e tjerë klientë duhet të mbajnë maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën. Ata duhet gjithashtu të përdorin dorezat mbrojtëse sipas këshillave;
- Rekomandohet shmangia e parasë *cash* dhe ofrimi shërbimeve me pagesë me kartë krediti;
- Në çdo rast të sigurohet ventilim (ajrimi) natyral të paktën 5 herë në ditë. Subjektet të marrin masat përkatëse për ndërhyrje në sistemet e ventilimit ku të kalohet në modalitetin e ajrit natyral apo përmes shtimit të dritareve.

YELLOW PROTOCOL OF HYGIENIC SANITARY MEASURES COVID-19

The entity initially verifies the object of its activity by self-determining the level of risk according to the activity codes. In the case of activities of a mixed nature where the entity exercises several activities, self-determination will be performed according to the secondary addresses and the type of each activity. The entity is allowed to carry out its activity during the permitted time slot.

This protocol applies also to activities that have 25-50 employees working in a common closed environment.

The person appointed by the administrator / Entrepreneur:

- Performs daily assessment of the presence of COVID-19 symptoms of the employees. In case of symptoms, it should not be allowed in any case to continue the activity by the relevant person and it should be reported immediately as a case by calling the number 127. If the person shows symptoms while working or after work, this person should be quarantined in a separate environment of the facility until appropriate measures are taken by the health care services;
- In any case, the Administrator/Entrepreneur shall immediately notify the relevant structures, especially the Local Health Care Unit and the Public Health Inspectorate.

The appointed person by the administrator/ entrepreneur, measures the temperature of the employees and any other client entering and exiting the premises with the infrared thermometer and immediately notifies the relevant structures for temperatures higher than 37.5 degrees in cases where there are also other COVID-19 symptoms.

The entity should:

- Provide constantly and by its own means protective gloves, masks and hand sanitizers with over 60% alcohol;
- Provide constantly and by its own means and at any time soap, hand cleaning paper, surface disinfectants and closed trash bins that need to be cleaned every day;
- Provide hand sanitizer for staff and anyone who enters and exits the interior premises and takes care of their replenishment. The percentage of active substance should be at least 60% alcohol;
- Guarantee and respect at any time the distance of 2 meters between the employed staff and between the latter and the clients. The entity reorganizes its work with shifts according to an individual plan in order to comply with the above obligation;

- Perform environmental disinfection and cleaning before and after opening and at least 3 times a day. Dirty surfaces are first cleaned with soap and water and then disinfected with other products. Each employee performs disinfection with the hygiene products of desks, counters, telephones, computers, headphones and any space or object where there has been touch contact at the beginning and end of the shift. The products are used in accordance with the relevant instructions from the manufacturer/seller or the Ministry of Health;
- Place protective glass (plexiglass) between the employee and the client;
- Serve as many customers as there are cash registers or customer service counters, while others wait outside in queues;
- Display the list of COVID-19 symptoms according to the approved checklist;
- Display the information poster on COVID-19 risk reduction according to the approved format;
- Display the statement for the implementation of the yellow protocol, according to the approved format, which includes the obligation for self-assessment of symptoms by the employed staff / administrator / any other third party entering and leaving the interior premises according to the approved format where administrative or criminal responsibility is stressed out for the person who does not take measures according to legal obligations as well as the toll free number for denunciation;
- Fully display the yellow protocol according to the approved text.

The above materials are displayed at the entrance of the entity as well as in visible places inside the entity.

Employees:

- Perform daily self-assessment if they have symptoms of COVID-19 according to the approved checklist. In case of symptoms, the person should immediately notify by calling the number 127 and the Administrator/Entrepreneur. In no case should the activity of the respective person be allowed to continue and, as the case may be, should be quarantined in the predetermined premises;
- Are obliged to declare to the Administrator/Entrepreneur if they have had contact with persons who result or have tested positive with COVID-19;
- If notice clinical signs during their stay at home should not show up for work and should immediately notify the Administrator/Entrepreneur and call the number 127 and the family doctor;
- Shall not use the tools or workplace of colleagues without performing disinfection.

General rules:

- Going to work and returning home from work by foot is performed by maintaining a distance of 2 meters and by not creating groups. In case of going to work with bus transport service, employees sit on the sides of the bus by the windows and leave a space empty line behind them. Masks and gloves must be worn on the bus or vehicle and touching of surfaces must be avoided. The bus is disinfected and ventilated every day. For vehicle circulation, the measures published by the State Police should be applied;
- During time-off at work and meal break, avoid gatherings of people in rooms such as kitchens, dining rooms or outdoor areas, whether public or private;
- Coughing and sneezing are performed using the elbow or using a handkerchief. The handkerchief is immediately thrown into the bin;
- In no case is physical contact allowed between employees or between third party, including greetings;
- Employees and other clients must wear a protective mask covering their nose and mouth. They should also use protective gloves following the advice;
- It is recommended to avoid cash payments as well as it is recommended credit card payment services;
- In any case, provide natural ventilation (aeration) at least 5 times a day. Entities should take appropriate measures to intervene in ventilation systems where to switch to natural air mode or through the addition of windows.